



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 25.7.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci dhe Driton Çausi.

Munguan: Fidan Rekalju, Abdyl Salihu, Verica Çeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Përfaqësues të tjerë: Mevlide Shamolli-Ministria e Financave, Alush Istogu-Ministria e Arsimit dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+“, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+“, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport

Ismajl Kurteshi, tha se shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS+", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport, është i një rëndësie të veçantë, andaj propozoi që i njëjti të procedohet në Kuvend për ratifikim me procedurë të përshpejtuar, meqë përmes këtij ratifikimi do të përfitojnë studentët e universiteteve të Republikës së Kosovës.

Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji Projektligjin nr.06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99;

Ismajl Kurteshi, tha se në këtë mbledhje janë ftuar përfaqësuesit e ministrive përkatëse, ai i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, që të japin kontributin e tyre për shqyrtimin e mëtejshëm të projektligjit.

Alush Istogu, përfaqësuesi i MASHT-it, tha se jemi vonuar për këtë projektligj, ndërkaq, çështja e kostos buxhetore, sipas tij është obliguese. Po ashtu, Istogu shtroi nevojën e një planifikimi buxhetor nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për implementim të këtij ligji.

Mevlide Shamolli, përfaqësuese e Ministrisë së Financave, foli për implikimet buxhetore që përbën ky projektligj e për të cilat është bërë debat i gjerë lidhur me vlerësimin financiar, duke vënë në pah se ky ligj ka kosto të lartë buxhetore, e cila është e pa përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ajo, theksoi se parashikimet e MF-së janë brenda kornizës ligjore, ndërkaq implikimet buxhetore janë jashtë kornizave ligjore. Në fund të takimit, Shamolli bëri të ditur se nuk mund t’ju japë të drejtë dhjetë mijë përfituesve që të kategorizohen, ngase, siç tha ajo, ende nuk është specifikuar numri i saktë i mësimdhënësve që kanë përvojë dhjetëvjeçare. Sipas saj, është dëshmuar që pensioni prej 240 eurosh do ta fusë shtetin në minus.

Teuta Haxhiu, tha se është duke u bërë politikë me këtë projektligj. Nuk ka arsye për vonesa të miratimit të këtij projektligji dhe nuk pajtohet me vlerësimin e Ministrisë së Financave, sa i përket kostos buxhetore.

Pas një debati mes anëtarëve, kryesuesi e ndërpreu mbledhjen me qëllim që shqyrtimi i projektligjit të vazhdojë në grup punues.

4. Të ndryshme.

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi